



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 983/prot.
2

Tiranë më 02. 7.2018

VENDIM

Nr. 26, datë 02. 7.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 983 Prot., datë 04.06.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Bashkisë Fier" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 15.05.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

1. *Një kopje e Vendimit nr. 61 datë 25.11.2011 Këshillit të Bashkisë Fier "Për lejimin e ndërtimit të ambjentëve sportive, parqeve, gjelbërimit, parkingjeve, rrugë trotuare sipas studimit urbanistik të miratuar nga vendimi KRRT nr. 9 datë 28.09.2010 nga shoqëria "Elkos Sh.p.k" në lagjen "8 Shkurti" Fier*.
2. *Një kopje të Vendimit nr. 9 datë 28.09.2010 të KRRT-së për miratimin e studimit urbanistik për investimet në lagjen "8 Shkurti"*.
3. *Gjithë materialet e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtoria e Përgjithshme e Zbatimit të Legjislacionit dhe kërkesën zyrtare të*

- Shoqërisë Elkos sh.p.k. së bashku me projektvendimin, në funksion të Vendimit nr. 61, datë 25.11.2011 të Këshillit të Bashkisë Fier.*
4. *Studimi i hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zbatimit të Legjislacionit për zhvillimin urbanistik të zonës në lagjen "8 Shkurti", ku parashikohet që në këmbimin e investimit të Shoqërisë Elkos sh.p.k., të ofrohet nga Bashkia e Fierit një sipërfaqe toke truall për parkim në favor të kësaj shoqërie.*
 5. *Të dhëna lidhur me sipërfaqen e truallit që i është ofruar Shoqërisë Elkos sh.p.k., për parkim nga ana e Bashkisë Fier, në këmbim të zhvillimit urbanistik të zonës. Sa është sipërfaqja e truallit (në metra katrorë) që Bashkia e Fierit i ka ofruar për parkim Shoqërisë Elkos sh.p.k..*
 6. *Të dhëna lidhur me investimet e kryera nga viti 2011 e deri tani nga Shoqëria Elkos sh.p.k., në funksion të zbatimit të studimit urbanistik të miratuar nga KRRR me Vendimin nr. 9, datë 28.09.2010, për investime në lagjen "8 Shkurti" Fier.*
 7. *Ju lutem specifikoni investimet e kryera që prej vitit 2011 e në vazhdim nga Shoqëria Elkos sh.p.k., në gjelbërim, rrugë, trotuare, parqe, parkingje dhe ambiente sportive, në funksion të zbatimit të Vendimit nr. 61 datë 25.11.2011 i Këshillit të Bashkisë Fier, ku të pasqyrohen për secilin investim, projektet përkatëse, kostot financiare të hartimit të projekteve, kostot financiare të zbatimit të projekteve, data e realizimit të projekteve dhe burimi financiar për secilin hartim dhe zbatim projekti.*
 8. *Të dhëna lidhur me hartimin e projektit për ndërtimin e pallatit të lojrave me dorë pranë ETC, në lagjen "8 Shkurti" Fier, ku pasqyrohet kostoja financiare e hartimit të projektit, data e nisjes së punimeve, kostoja financiare për ndërtimin e godinës së pallatit të lojrave me dorë, arsyeja e mospërfundimit të këtij projekti, statusi aktual i projektit dhe burimi i financimit të hartimit e ndërtimit të pjesshëm të projektit të pallatit të lojrave me dorë në lagjen "8 Shkurti" Fier.*
 9. *Të dhëna lidhur me ambientet sportive të lojrave me dorë të ndërtuara së fundmi përbri pallatit të lojrave me dorë, pranë ETC-së në lagjen "8 Shkurti" Fier, ku të pasqyrohen të dhënat lidhur me: kostot financiare të hartimit të projektit, datën e nisjes së punimeve, kostot financiare për realizimin e këtij projekti, burimin e financimit të hartimit të projektit dhe të realizimit të këtij projekti.*
 10. *Arsyet përse u braktisën punimet për përfundimin e pallatit të lojrave me dorë që ndodhet pranë ETC-së në lagjen "8 Shkurti" Fier dhe arsyet përse përbri ndërtesës së papërfunduar të pallatit të lojrave me dorë, u ndërtuan të tjera ambiente sportive të lojrave me dorë, ku janë përdorur pajisje të çmontueshme për realizimin e këtyre ambienteve sportive, duke mos mundur praninë e stadiumit për sportdashësit.*

Autoriteti Publik me anë të postës elektronike, i ka kthyer përgjigje kërkuesit duke cituar se: *"Bashkia Fier është duke e studiuar e rivlerësuar situatën për të përcaktuar zhvillimet e mëtejshme. Sapo të përfundojë ky proces do t'ju informojmë".*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 983 Prot., datë 04.06.2018 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me shkresën nr. 983/1 Prot., datë 11.06.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik rivlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 18.06.2018.

Në tejkallim të afateve të përcaktuara në Ligjin për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur objektin e kërkesës për informacion.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Ligji për të Drejtën e Informimit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror që ushtron funksione publike. Njësitë e qeverisjes vendore kanë këtë detyrim edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, konkretisht neni Neni 15 “Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore”, në të cilin parashikohet se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”*

Gjithashtu bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, një pjesë e dokumenteve të sipërcituara në kërkesën e datës 15.05.2018, përfshihen në kategoritë e informacionit që kërkohen në programin e transparencës, të cilat duhet të vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Si rrjedhojë, duke qenë se informacioni që kërkohet është informacion publik, atëherë dhe dhënia e tij është një detyrim ligjor që do të përmbushi kërkesën për informim dhe do të rrisë ndjeshëm transparencën. Sa më sipër, nëse informacioni i kërkuar disponohet nga autoriteti publik, duhet të procedohet me dhënien e tij.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Z.

ndaj Autoritetit Publik.

Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 983 Prot., datë 04.06.2018 të Z. , kundër Autoritetit Publik "Bashkisë Fier", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 15.05.2018, brenda datës 09 . 7 .2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 02 . 7 .2018.

